



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA PUKË  
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit

Nr. 2352 prot.

Pukë, më 23/12/2021

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 03, Datë 23/12/2021

**PËR  
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47, DATË 17.12.2004”, PËR EMËRTIMIN E  
RRUGËVE, SHESHEVE DHE INSTUTICIONEVE TË BASHKISË PUKË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, nën pika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); si dhe neni 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, nenit 7, neni 25, nenit 26, të Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar); Ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, (i ndryshuar), VKB-së nr.47, datë 17.12.2004 “Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instuticioneve të Bashkisë Pukë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim kërkesën,

**VENDOSI:**

1. Në pikën 3 të VKB-së nr.47, datë 17.12.2004 “Për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instuticioneve të Bashkisë Pukë”, shtohet **germa g** Për emërtim rruge “Ukmemaj”, fshati Bicaj në Njësinë Administrative Rrape sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1 të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hy në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër.

**Hartuesi**  
**Drejtori i Urbanistikës**  
Alda Mema

**Juristi**  
Igli Trupja

**KRYETARI**  
**GJON GJONAJ**



**RELACION  
PËR  
PROJEKT-VENDIMIN PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47, DATË 17.12.2004”,  
PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE DHE INSTUTICIONEVE TË BASHKISË  
PUKË”**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak**

**Të nderuar Këshilltare/Keshilltar**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe të ligjit nr. 9270/2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar), lind nevoja e emërimit të rrugëve të pa emërtuara në territorin e Bashkisë Pukë apo dhe ndryshimin e disa emërtesave me propozim të banorëve të zonës dhe dijeninë e njësisë administrative, ku një ndër këto është rruga që kalon në fshatin Bicaj (sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur), që aktualisht mban emrin “Pal Nikaj”, emërtesë e cila nuk ka dokumentacion të miratuar sipas Këshillit Komunal të kohës apo dhe Këshillit Bashkiak.

Për emërtimin e këtij segmenti, propozohet emërtesa rruga “Ukmemaj” sipas emrit që mban dhe lagjia e këtij fshati. Emërtimi i rrugës do të bëhet sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur këtij relacioni ku përcaktohet qartë segmenti rrugor, që do të emërtohet.

Nisur nga faktet e sipërcituara kërkojmë nga ana juaj të miratohet projekt-vendimi “Për një shtesë në vendimin nr.47, datë 17.12.2004”, për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe instuticioneve të Bashkisë Pukë”.


Ju faleminderit!

**Hartuesi  
Drejtori i Urbanistikës  
Alda Mema**

**KRYETARI  
GJON GJONAJ**



# HARTA TREGUESE EKZISTUESE



Coordinate System: ETRS 1989 Albania 2010  
Projection: Transverse Mercator  
Datum: ETRS 1989  
False Easting: 500,000.0000  
False Northing: 0.0000  
Central Meridian: 20.0000  
Scale Factor: 1.0000  
Latitude Of Origin: 0.0000  
Units: Meter

1 centimeter = 60 meters

